



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

# STRATEGJIA E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



2019-2023

**Titulli:** Strategjia e Shkollës së Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë

**Përgatiti:** Grupi i punës së Shkollës së Magjistraturës në bashkëpunim me EURALIUS V.

**Redaktor:** Anila Haruni

**Përkthyes:** Edlira Osmani dhe Ador Koleka

**Design & Layout:** Irisi Asllanaj

**Shtypur në shtypshkronjën:** MORAVA

© Shkolla e Magjistraturës

**Shkolla e Magjistraturës**

Rruga e “Elbasanit”, Fakulteti i Gjeologji Minierave, Kati IV, Tiranë

E-mail: [info@magjistratura.edu.al](mailto:info@magjistratura.edu.al)

Web: [www.magjistratura.edu.al](http://www.magjistratura.edu.al)

# PËRMBAJTJA

## **1. KAPITULLI I. HYRJA DHE METODOLOGJIA**

- 1.1. Hyrje
- 1.2. Parathënie
- 1.3. Metodologjia

## **2. KAPITULLI II. KONTEKSTI, ARSYETIMI DHE VLERËSIMI I RISKUT**

- 2.1. Analiza ligjore dhe institucionale
- 2.2. Marrëdhënia e Shkollës me përfituesit dhe bashkëpunëtorët
- 2.3. Analiza e problemeve
  - 2.3.1. Mungesa e kapaciteteve infrastrukturore
  - 2.3.2. Mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare
  - 2.3.3. Mungesa e kapaciteteve akademike
  - 2.3.4. Pamjaftueshmëria e botimeve cilësore
  - 2.3.5. Kapaciteti i kufizuar i rekrutimit
- 2.4. Efektet e problemeve të evidentuara

## **3. KAPITULLI III. PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE**

## **4. KAPITULLI IV. MONITORIMI DHE ANALIZA E ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMEVE**

## KAPITULLI I HYRJA DHE METODOLOGJIA

### 1.1. HYRJE

**Sh**kolla e Magjistraturës, gjatë 21 viteve të veprimtarisë dhe të funksionimit të saj, ka hedhur themelet e sistemit të drejtësisë, nëpërmjet përgatitjes së gjyqtarëve e prokurorëve me një nivel më të lartë profesional, etik dhe moral, por edhe krijimit të një kulture e fizionomie të re mbi modelin e ri të magjistratit.

Si një institucion i pavarur ndaj pushteteve të tjera, i përbërë nga profesorët më të shquar të jurisprudencës, por edhe nga magjistratët që arrinin të ruanin integritetin e tyre dhe të sillnin përvojën e praktikës dhe e orientuar nga parimi i lirisë akademike, Shkolla e Magjistraturës ka synuar përzgjedhjen e moduleve më të mira mësimdhënëse, që padyshim kanë ndikuar në rritjen e cilësisë dhe të profesionalizmit të magjistratëve të rinj. Ajo është institucioni i vetëm që ofron formimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke përmbushur detyrimin ligjor mbi trajnimin vazhdues të tyre, nëpërmjet një programi të pasur dhe metodave shkencore.

Ndihma e vazhdueshme dhe kontributi tepër i rëndësishëm që kanë dhënë organizmat ndërkombëtarë ka qenë dhe mbetet përcaktues për evidentimin e Shkollës së Magjistraturës si një institucion elitar i dijes, por edhe si një nga organizmat e paktë, të vlerësuar brenda sistemit të kritikuar të drejtësisë. Ka qenë kjo veprimtari e vlerësuar në vite, që ka shërbyer për ta ngritur Shkollën e Magjistraturës në nivelin e një institucioni kushtetues, duke e renditur krahas organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Pas dy dekadash veprimtarie, në stadin në të cilin ndodhet aktualisht sistemi i drejtësisë, i përket Shkollës së Magjistraturës të shkruajë historinë e një drejtësie të re, që bazohet në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës, që do të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Shkollës së Magjistraturës për të forcuar besimin e qytetarëve shqiptarë te magjistratët që formon, të cilët duhet të garantojnë pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës.

Jemi dëshmitarë të asaj çfarë po ndodh me sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Pas ndryshimeve kushtetuese dhe miratimit të ligjeve të reformës në drejtësi Shkolla e Magjistraturës funksionon dhe ushtron veprimtarinë e saj, me më shumë sfida dhe përgjegjësi të mëdha. Tashmë, çdo jurist që kërkon të bëhet pjesë e sistemit të drejtësisë, nuk ka portë tjetër hyrëse, përveç Shkollës së Magjistraturës.

Në përputhje me drejtimet dhe objektivat e Reformës në Drejtësi, Shkolla e Magjistraturës ka si detyrë funksionale jo vetëm sigurimin e formimit fillestar dhe vazhdues të magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë), por edhe ofrimin e programit të formimit fillestar dhe të vazhdueshëm, të profilizuar për kategori të ndryshme juristësh, ku përfshihen avokatët e shtetit, ndihmësit ligjorë dhe kancelarët në gjykata e prokurori. Roli i Shkollës së Magjistraturës në procesin për përzgjedhjen e përfaqësuesve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si dhe prania e drejtuesve të këtyre organeve në Këshillin Drejtues të saj, krijojnë të gjitha hapësirat e domosdoshme ligjore për pasjen e një bashkëpunimi më të ngushtë në shkëmbimin e përvojës dhe për paraqitjen e kërkesave e të nevojave në përmbushjen me sukses të detyrave institucionale.

Një rrugë e re po shtrohet për sistemin e drejtësisë shqiptare dhe Shkolla e Magjistraturës merr peshën e saj të përgjegjësisë. Për sigurimin e një zhvillimi cilësor e të qëndrueshëm të sistemit të drejtësisë, përpara Shkollës së Magjistraturës shtrohen shumë më tepër detyra që nevojiten të planifikohen, programohen dhe zbatohen në kohë me qëllim garantimin e një drejtësie eficiente. Në funksion të marrjes së përgjegjësisë të reja dhe përmbushjes me sukses të veprimtarisë të saj, ka dalë natyrshëm nevoja për hartimin e një Strategjie të re për Shkollën, nëpërmjet së cilës duhet të zërthehen në terma konkretë misioni dhe detyrat që i janë ngarkuar.

Në këtë kuadër, në konsultim të ngushtë me stafin pedagogjik dhe administrativ të Shkollës së Magjistraturës, si dhe me asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS V, është përgatitur Strategjia

e re. Në këtë strategji janë analizuar me kujdes nevojat dhe problematikat që ka hasur Shkolla gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim zgjidhjen urgjente të problemeve që diktohen nga situata e krijuar, pa ceduar standardin e cilësisë së mësimdhënies dhe për të planifikuar në mënyrë realiste afatmesme dhe afatgjatë objektivat që duhen arritur.

Në Strategji janë reflektuar qartë, duke bërë analizën ligjore dhe institucionale, prioritetet dhe qëllimet strategjike, objektivat dhe politikat që ka Shkolla për zhvillimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së mëtejshme të saj, për sa i përket Formimit Fillestar, Formimit Vazhdues, Publikimeve, punës kërkimore-shkencore, infrastrukturës, burimeve financiare e njerëzore të saj.

Shkolla e Magjistraturës ka si orientim kryesor vazhdimin e të gjithë asaj pune të vlerësueshme, që të tjerët e kanë filluar më parë dhe që e kanë sjellë në këtë stad. Tashmë jemi në një tjetër realitet që kërkon një ridimensionim të rrugës që do të ndiqet.

Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë është e orientuar për kapacitetet e nevojshme që kërkohen për vënien në zbatim të kësaj Strategjie, me synimin për të bërë të mundur realizimin e drejtësisë që dëshirojmë.

Misioni strategjik është dhe mbetet formimi profesional i magjistratëve, por edhe i aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë, me aftësi dhe cilësi të larta profesionale, morale dhe etike, me qëllim rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë, si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimit të shtetit ligjor. Si një institucion elitari i dijes për formimin fillestar të magjistratëve dhe nëpunësve të tjerë të sistemit të drejtësisë dhe në pararojë të institucioneve të edukimit ligjor, në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Shkolla e Magjistraturës do të vijojë të orientohet drejt përmirësimit dhe zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të punës kërkimore shkencore me synimin e kthimit të saj në një qendër për shkëmbimin aktiv të ideve në lidhje me tematikën ligjore mbi praktikën gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sidoqoftë, identifikimi i kandidaturave me integritet profesional e moral, që përzgjidhen për të kryer funksionin e magjistratit, si dhe përgatitja e tyre dhe e magjistratëve të sistemit është misioni kryesor i Shkollës së Magjistraturës. Nëse duam të dimë se si do të jenë gjyqtarët dhe prokurorët e së ardhmes, duhet të shohim sfidat me të cilat përballet sot Shkolla e Magjistraturës, në përmbushjen e misionit të saj për implementimin e reformës në drejtësi. Kjo është përgjegjësia e madhe e Shkollës së Magjistraturës, e parë edhe në një realitet krejt të ri që imponon zbatimin e kësaj reforme të thellë në drejtësi dhe që kërkon një ridimensionim të rolit të saj, për të përgatitur në 5 vitet në vijim, modelin e magjistratit që dëshirojmë me shpresën se drejtësia do të bëhet.

**Prof. asoc. dr. Sokol SADUSHI**  
**Drejtor i Shkollës së Magjistraturës**



**Sh**kolla e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë është krijuar me ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar me ligjin nr. 9414, datë 20.5.2005 dhe me ligjin nr. 97/2014), si një gur i fortë themeli në fushën e së drejtës, specifikisht (por jo vetëm) për realizimin e edukimit profesional në këtë fushë. Në realitetin e sotëm, me reformimin e plotë që po bëhet në sistemin e drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës është në nivelin e një institucioni të parashikuar nga Kushtetuta, veprimtaria dhe funksionimi i të cilës rregullohet nëpërmjet disa ligjeve me shumicë të cilësuar, si: ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Shkolla është përgjegjëse për Formimin Fillestar dhe Vazhdues të magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë), të avokatëve të shtetit, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve në gjykata dhe prokurori. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkolla ka rol të rëndësishëm në formimin profesional të administratës gjyqësore.

Në kuadër të përmbushjes së kësaj përgjegjësie është punuar për hartimin e strategjisë (2019-2023), në përputhje me kriteret dhe metodikën e përcaktuar dhe rekomanduar nga misioni EURALIUS V, të cilët kanë kontribuar me mbështetje nëpërmjet ekspertëve të tyre.

**Misioni i Shkollës** sa delikat, aq edhe thelbësor e profesional, mbart në vetvete Strategjinë më të besueshme e të qëndrueshme për funksionimin e hallkës së parë të sistemit të drejtësisë dhe ndikimin e vazhdueshëm në një proces zinxhir me pasoja dhe rezultate afatgjata. Rritja e aksesit në drejtësi, rritja e besimit të publikut të drejtësia shqiptare, paralelisht me forcimin dhe rritjen më tej të kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare do të shërbejë edhe si një nxitje në përsheptimin e integritetit evropian.

**Vizioni i Shkollës** është përgatitja, zhvillimi i qëndrueshëm dhe profesional i magjistratëve, por edhe i aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, si avokatët e shtetit, ndihmësit ligjorë, këshilltarët ligjorë dhe kancelarët e gjykatave dhe prokurorive, me integritet të lartë etik e moral, në mënyrë që të punojnë drejt rivendosjes së besimit të shoqërisë në drejtësi dhe përmirësimin e kulturës ligjore.

### 1.3 METODOLOGJIA

**H**artimi e konceptimi i kësaj strategjie është bazuar në politikat ekzistuese të qeverisë shqiptare, të cilat orientohen drejt perspektivës për aderim në Bashkimin European. Prezantimi i këtyre politikave jepet nëpërmjet dokumenteve kyçe, si: “*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim*”, “*Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë*”, “*Plani Kombëtar për Integrimin European*” dhe “*Progres Raporti i vitit 2018 i Komisionit European*”. Strategjia e Shkollës së Magjistraturës merr në konsideratë edhe faktin se për çështje apo fusha të caktuara veprojnë strategji të veçanta, ku mund të përmendim “*Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2018-2021*”, në të cilën bëjnë pjesë edhe objektivat e Shkollës së Magjistraturës.

Strategjia e hartuar është një propozim për përmirësimin dhe zhvillimin e Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet planifikimit, administrimit dhe menaxhimit më të efektshëm të saj.

Objekivi i hartuesve të këtij dokumenti është, ndër të tjera, që politikat e evidentuara në përmbajtjen e tij të kontribuojnë në promovimin e bashkëpunimit me partnerë brenda dhe përtej sistemit të drejtësisë, por sigurisht që aty ku është e mundur, synohet edhe bashkëpunimi me aktorë ndërqeveritarë, shqiptarë dhe të huaj me qëllimin e vetëm: hartimin e politikave dhe planeve të mëtejshme e me bazë më të gjerë.

Procesi i hartimit të kësaj strategjie ka qenë gjithëpërfshirës, duke përfshirë grupet e interesit, institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, si dhe bashkëpunimin e ngushtë me ekspertët e EURALIUS-it. Një grup pune me pedagogë të brendshëm të Shkollës dhe personelit administrativ është ngritur me urdhër të Drejtorit të Shkollës për të diskutuar dhe analizuar situatën në të cilën ndodhet Shkolla e Magjistraturës, duke ju referuar ndryshimeve të legjislacionit në kuadër të Reformës në Drejtësi, si dhe cilat janë sfidat për të ardhmen e saj.

Grupi i punës ka identifikuar dhe paraqitur qëllimet strategjike për periudhën 2019-2023 dhe masat e ndërlydhura. Të gjitha këto gjetje fillestare u përpunuan, u analizuan dhe u harmonizuan në takimet e grupit të punës dhe me ekspertët e misionit EURALIUS V dhe më pas në diskutime të tjera me Këshillin Pedagogjik dhe Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës. Të gjitha rekomandimet janë përfshirë në tekstin përfundimtar të këtij dokumenti.

Të gjitha masat në Planin e Veprimit të kësaj strategjie janë të prioritizuara, të buxhetuara dhe të ndara në faza. Ndarja e masave në faza është kryer në përputhje me kapacitetet absorbuese të pritshme të Shkollës së Magjistraturës. Qëllimi i ndarjes në faza ndjek rrjedhën logjike, me qëllim që zbatimi i tyre të realizohet edhe në mënyrë kronologjike.

## KAPITULLI II

### KONTEKSTI, ARSYETIMI DHE VLERËSIMI I RISKUT

#### 2.1. ANALIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

**Sh**kolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë, me qendër në Tiranë, është një institucion me pavarësi institucionale, akademike dhe administrative, e parashikuar, pikësepari, në Kushtetutë, si dhe e rregulluar me ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ndryshimet e legjislacionit në kuadër të procesit të reformës në drejtësi e kanë rritur disa herë rolin e Shkollës, duke e kthyer në një nga organet kryesore të sistemit të drejtësisë, me përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:

- Rekrutimin dhe formimin profesional fillestar teorik dhe praktik të kandidatëve për magjistratë;
- Rekrutimin dhe formimin profesional fillestar teorik dhe praktik të kandidatëve për pozicionet në Avokaturën e Shtetit;
- Rekrutimin dhe formimin profesional fillestar teorik dhe praktik nëntëmujor të kandidatëve për ndihmës ligjorë dhe këshilltarë ligjorë;
- Rekrutimin dhe formimin profesional fillestar teorik dhe praktik të kandidatëve për kancelarë të gjykatave dhe prokurorive me një kohëzgjatje tremujore;
- Formimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, të avokatëve të shtetit në detyrë dhe ndihmësve ligjorë e kancelarëve që punojnë në gjykata dhe prokurori;
- Përmbushjen e të gjitha funksioneve që burojnë nga ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit 1-vjeçar të subjekteve të rivlerësimit, të evidentuara me mangësi në aftësitë e tyre profesionale.
- Bashkëpunimin me KLGJ/KLP, Ministrinë e Drejtësisë për realizimin e veprimtarive të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore, si dhe të profesioneve të tjera që lidhen me sistemin e drejtësisë, në përputhje me ligjin ose me kërkesë të institucioneve të interesuara;
- Ofrimin e botimeve dhe publikimeve; bërjen e kërkimeve shkencore dhe përgatitjen e analizave, memove e ekspertizave me synimin për t’u kthyer në një qendër të vërtetë kërkimore dhe shkencore.

#### 2.2. MARRËDHËNIA E SHKOLLËS ME PËRFITUESIT DHE BASHKËPUNËTORËT

Shërbimin e forcimit të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, bashkëpunimin e afërt me institucionet e tjera të shtetit shqiptar, e konsiderojmë si një nga drejtimet kryesore të punës së Shkollës.

Kemi pasur dhe do të vazhdojmë të kemi bashkëpunim shumë të mirë me të gjithë përfituesit nga veprimtaria akademike dhe profesionale e Shkollës, por njëkohësisht edhe marrëdhënie të frytshme me institucione kryesore, si Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë dhe komunitetet e magjistratëve, avokatëve, ndihmësve ligjorë, kancelarëve dhe të gjithë aktorëve të tjerë që ndërveprojnë me Shkollën.

Përfituesit e drejtpërdrejtë të veprimtarisë akademike dhe profesionale të Shkollës janë kandidatët për magjistratë, magjistratët në detyrë, kandidatët për këshilltarë/ndihmësit ligjorë dhe ata



në detyrë, kandidatët për avokatë të shtetit dhe avokatët e shtetit në detyrë, kandidatët për kancelarë dhe kancelarët në detyrë, të cilët duhet të ndjekin programet përkatëse të formimit profesional të ofruara nga Shkolla e Magjistraturës.

Përfitues jodirekt nga veprimtaria e saj akademike janë avokatët, noterët, përmbaruesit, oficerët e policisë gjyqësore, administrata gjyqësore, të cilët mund të jenë përfitues të trajnimeve për tematika të posaçme, si dhe nga rritja e efikasitetit të profesionalizimit të magjistratëve.

Bashkëpunëtorë të programeve të saj janë institucione të ndryshme, si Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Avokatura e Shtetit, Donatorët Ndërkombëtarë, Rrjetet e ndryshme ndërkombëtare të Trajnimit Gjyqësor, Shkolla e Administratës Publike, Akademia e Sigurisë, të cilat ofrojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve organizative dhe institucionale të Shkollës.

Institucione të tjera shtetërore të interesuara për veprimtarinë e saj, si Departamenti i Administratës Publike, Komisioni për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioni i Prokurimit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ofrojnë asistencë me grupe ekspertësh si dhe auditim të veprimtarisë së Shkollës.

### **2.3. ANALIZA E PROBLEMEVE**

Pozita e re e Shkollës, pas ndryshimeve të legjisllacionit të reformës në drejtësi, ka shtuar përgjegjësitë dhe detyrimet, të cilat gjejnë vështirësi për t'u zbatuar në gjendjen aktuale ku ndodhet ajo, në drejtim të infrastrukturës, stafit akademik dhe administrativ, programeve të formimit profesional dhe punës kërkimore-shkencore.

#### **2.3.1. MUNGESA E KAPACITETEVE INFRASTRUKTURE**

Shkolla e ka filluar aktivitetin e saj në datën 1.10.1997 në mjediset e Fakultetit të Gjeologji Minerave të Universitetit Politeknik, në gjysmën e katit të katërt, sipas shkresës së ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 882/1, datë 3.9.1997. Në kuadrin e zhvillimit të aktivitetit të saj, diktuar edhe nga detyrimi për përmbushjen e kërkesave gjithmonë e në rritje për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, me urdhrin nr. 173, datë 7.7.2000 të Kryeministrit, u kalua në administrim të Shkollës së Magjistraturës i gjithë kati i katërt i kësaj godine.

Në këto mjedise ka vetëm një sallë për Formimin Fillestar, ku ndjekin kurset rreth 25-30 kandidatë për magjistratë çdo vit, një sallë për Formimin Vazhdues, ku trajnohen grupe me rreth 30 persona, një sallë për gjyqin imitues me një maksimum vendesh prej 30 personash, një bibliotekë dhe tetë zyra për stafin akademik dhe personelin administrativ.


Ka mungesa të infrastrukturës në drejtim të teknologjisë së informacionit dhe mjeteve të transportit.

#### **2.3.2. MUNGESA E KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE**

Aktualisht, Shkolla e Magjistraturës ka një staf prej 31 punonjësish, të ndarë në 3 departamente të përbërë nga 8 pedagogë të brendshëm dhe 6 sektorë të përbërë nga 21 nëpunës civilë si dhe 2 punonjës mbështetës.


Në funksion të përmbushjes së angazhimeve të reja stafi i brendshëm prej 31 personash është i pamjaftueshëm për realizimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme të veprimtarisë akademike dhe administrative. Krahas kësaj, stafi i jashtëm aktual i angazhuar në Programin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues nuk mund të përballojë nevojat në rritje të programeve të formimit profesional.

Më poshtë paraqitet dinamika e ndryshimit të numrit të punonjësve në një hark kohor prej rreth 21 vitesh:



<sup>1</sup> Të dhëna të nxjerra nga borderotë në vite.

Për sa më sipër, mbështetja e nevojshme financiare realizohet nga buxheti i shtetit, me një rritje të konsiderueshme nga vitet paraardhëse, që arrin të mbulojë një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë së Shkollës, megjithatë mbetet evidente mungesa e financimit të shpenzimeve të Programit të Formimit Vazhdues, punës kërkimore-shkencore, të investimeve për një godinë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të SHM-së, të teknologjisë së informacionit, mjeteve të transportit, por edhe mbështetjes së nevojshme financiare e burimeve njerëzore shtesë në kuadër të detyrimeve të shtuara.



### 2.3.3. MUNGESA E KAPACITETEVE AKADEMIKE

#### *I. Mungesa e kurikulave të trajnimit për grupet/kategoritë e reja si dhe rishikimi i kurikulave ekzistuese për kandidatët për magjistratë.*

Në kuadër të angazhimeve të marra Shkolla përballlet me vështirësi apo mangësi në përgatitjen a rishikimin e programeve mësimore, si më poshtë:

- ✓ Programi dhe plani mësimor për kandidatët për magjistratë, të cilët ndjekin ciklin trevjeçar të studimeve.

- ✓ Programet dhe planet mësimore të reja për avokatët e shtetit dhe ndihmësit/ këshilltarët ligjorë që do të ndjekin Formimin Fillestar për një periudhë 9-mujore në Shkollën e Magjistraturës.
- ✓ Programet dhe planet mësimore për kancelarët që do të ndjekin Programin e Formimit Fillestar për rreth 3 muaj në Shkollën e Magjistraturës.
- ✓ Programet dhe modulet e integruara në platformën *e-learning* për realizimin e trajnimeve në distancë.

## ***II. Rishikimi i programit të provimit të pranimit dhe modelit të testit për kandidatët për magjistratë dhe krijimi i modelit të testit për kancelarët.***

Shqipëria tashmë është duke ecur drejt rrugës së Bashkimit Europian dhe gjyqtari e prokurori shqiptar do të shihet si një magjistrat europian. Për këtë kërkohet:

- ✓ rishikimi i programit të provimit të pranimit dhe pasja e një modeli të testit të përshtatshëm për rekrutimin në cilësinë dhe sasinë e nevojshme të kandidatëve për magjistratë, avokatë shteti dhe ndihmës ligjorë, me qëllim thithjen e konkurrentëve me aftësi të larta logjike dhe interpretative të ligjit, të diplomuar brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ përgatitja e një programi provimi dhe modeli testi të përshtatshëm për kancelarët në detyrë dhe kandidatët për kancelarë.

### **2.3.4. PAMJAFTUESHMËRIA E BOTIMEVE CILËSORE**

- ✓ Mungesa e punës kërkimore-shkencore si pasojë e mospasjes së burimeve njerëzore dhe financiare të mjaftueshme.
- ✓ Pamjaftueshmëria e botimeve juridike cilësore dhe sasiore nga fusha të ndryshme si pasojë e mungesës së stimuljeve përkatës.
- ✓ Mungesa e tregut për shitjen dhe shpërndarjen e botimeve juridike të Shkollës, për shkak të përballjes me një indiferencë të lexuesve.

### **2.3.5. KAPACITETI I KUFIZUAR I REKRUTIMIT**

Shkolla e Magjistraturës po përballlet me një sfidë të jashtëzakonshme për shkak të nevojës për trefishimin e kapaciteteve të saj për të trajnuar në Programin e Formimit Fillestar jo më shumë se 75 kandidatë për magjistratë në vit, për një periudhë 5-7 vjeçare, me qëllim plotësimin e vendeve vakante që do të krijohen nga largimi i magjistratëve, të cilët nuk do të mund të kalojnë procesin e *vetingut* apo do të largohen nga sistemi për shkaqe të ndryshme.

Vështirësitë për të rekrutuar më shumë se 75 kandidatë në vit evidentohen kryesisht në:

- mungesën e cilësisë së të rekrutuarve, të cilët nuk e arrijnë pragun kualifikues me 60% të pikëve, (*sipas eksperiencës së viteve të shkuara paraqitur në tabelën më poshtë*), si dhe në:
- kapacitetet e pamjaftueshme akademike për mësimdhënie për shkak të kritereve të larta që parashikon ligji për përzgjedhjen e tyre, në veçanti për pedagogë të jashtëm (gjyqtarë e prokurorë në detyrë), të cilët, për shkak të specifikës së Shkollës së Magjistraturës si një shkollë profesionale, paraqiten si në shkollat e tjera homologe, në raportin 80% pedagogë të jashtëm dhe 20% pedagogë të brendshëm.

Viti akademik	Konkurruar	Vendet vakante	Kualifikuar me 60% të pikëve	Përqindja e të kualifikuarve
2012-2013	73	8	20	28%
2013-2014	98	11	39	40%
2014-2015	0	0	0	0
2015-2016	119	16	19	16%
2016-2017	153	25	59	39%
2017-2018	77	25	15	20%
2018-2019 (subjektet <i>ex officio</i> )	47		10	22%


#### 2.4. EFEKTET E PROBLEMEVE TË EVIDENTUARA

Në këndvështrimin e problemeve të evidentuara më lart, Shkolla po përballet me efektet e drejtpërdrejta të mungesave apo pamjaftueshmërisë në drejtim të:

1. cilësisë së të rekrutuarëve;
2. sasisë së të diplomuarve dhe përfituesve të trajnimeve profesionale të ndryshme, të cilat japin si rezultat;
3. një kulturë ligjore jo në nivelin e dëshiruar.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë grafike shkaqet e problematikave të evidentuara më lart.

## Struktura e problematikave





## KAPITULLI III PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

**O**bjektivi i përgjithshëm:  
Të kontribuojmë në rritjen e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në funksion të nevojave që rrjedhin nga reformat e vazhdueshme të drejtësisë; të kontribuojmë në përmirësimin e kulturës ligjore në sektor e në vend, si dhe në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

### Objektivi specifik:

Shkolla e Magjistraturës synon të ketë kapacitetet e mjaftueshme akademike dhe administrative për realizimin normal të veprimtarisë së saj.

Përbushja e objektivit strategjik të Shkollës do të realizohet nëpërmjet arritjes së rezultateve të mëposhtme:

**Rezultati 1.** Kapacitetet infrastrukturore të duhura për zhvillimin normal të aktivitetit akademik e administrativ dhe infrastruktura e përkohshme e financimi i siguruar si pasojë e kërkesës përkohësisht të lartë për nxjerrjen e magjistratëve për të garantuar zëvendësimin e domosdoshëm, si pasojë e procesit të *vetingut*, siç janë:

Përfitimi i hapësirave të përkohshme për përballimin e situatës tranzitore në sipërfaqe jo më pak se 2500 m<sup>2</sup>, si dhe një godine të re me mjedise të nevojshme, me sipërfaqe rreth 3500 m<sup>2</sup>, me qëllim shtimin e numrit të sallave të reja për trajnim, zyra për stafin pedagogjik dhe administrativ, si dhe mjedise të tjera të mjaftueshme për realizimin e programeve të formimit profesional për 120 – 150 kandidatë për magjistratë, avokatë shteti, ndihmës ligjorë, kancelarë etj në vit.

Krahas kësaj, mjediset do të plotësojnë nevojat për trajnimin e vazhduar në detyrë për rreth 700 magjistratë, 50 ndihmës ligjorë, 80 avokatë të shtetit dhe 50 kancelarë; mjediset e nevojshme për zhvillimin e provimit të pranimit, konferencave vjetore dhe faciliteteve të tjera për zhvillimin e programeve të trajnimit në distancë, laboratorë, biblioteka dhe botime.

Kapacitete të mjaftueshme të infrastrukturës, logjistikës, pajisjes së kandidatëve me bazën materiale të nevojshme, (laptop, kompjutera, tavolina pune, rafte librash, fond biblioteke), sigurimin e automjeteve për transferimin e bazës materiale, konsolidimin e sistemit online të të dhënave statistikore në drejtim të fushave të ndryshme të veprimtarisë së Shkollës, ku (kandidatët për magjistratë, gjyqtarë, prokurorë, pedagogë, ekspertë etj.) të kenë mundësi të përdorin informacionin e nevojshëm nëpërmjet internetit dhe intranetit.

**Rezultati 2.** Burimet njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për përballimin e nevojave për të ardhmen.

Dyfishimi i pritshëm i ngarkesës në programet mësimore, i cili do të sjellë angazhimin me dyfishin e kohës për stafin e brendshëm dhe të jashtëm pedagogjik, si dhe personelin administrativ; përmirësimi i performancës së personelit akademik të seleksionuar nga radhët e profesionistëve të drejtësisë, magjistratëve në karrierë, si dhe të atyre me përvojë në mësimdhënie dhe personelit administrativ nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme në aktivitetet trajnuese të organizuara nga vetë Shkolla e Magjistraturës ose/dhe në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike.

Burime financiare të mjaftueshme për ofrimin e programeve mësimore të formimit profesional, si dhe për kapacitetet institucionale në drejtim të infrastrukturës, logjistikës, pajisjes së kandidatëve me bazën materiale të nevojshme, (laptop, kompjutera, tavolina pune, rafte librash, fond biblioteke);

Automjetet për transferimin e bazës materiale, konsolidimin e sistemit online të të dhënave statistikore, në drejtim të fushave të ndryshme të veprimtarisë së Shkollës, ku (kandidatët për magistratë, gjyqtarë, prokurorë, pedagogë, ekspertë etj.) të kenë mundësi të përdorin informacionin e nevojshëm nëpërmjet internetit dhe intranetit.

**Rezultati 3.** Programet e formimeve profesionale fillestare për magistratët dhe kategoritë e tjera sipas ligjit realizohen sipas një metodologjie rekrutimi dhe kurikulash trajnimi të përditësuar, gjithëpërfshirëse dhe të mjaftueshme.

Programe të konsoliduara të provimit të pranimit, të testit të përgjithshëm dhe testit profesional, të cilat mundësojnë përthithjen, jo thjesht mbi njohuritë, por mbi aftësitë, të kapaciteteve më të mira të konkurrentëve në të dyja fazat e provimit; kurikula dhe plane mësimore të përmirësuara, sipas modeleve perëndimore, të pasura me njohuri dhe metoda bashkëkohore, duke siguruar në të njëjtën kohë konsolidimin e zbatimit të tyre me rigorozitet dhe profesionalizëm; kurikula të krijuara për grupet e reja (ndihmës ligjorë, avokatë shteti dhe kancelarë); programi i praktikës aktive të vitit të tretë, stazhi profesional, i përmirësuar përsa i përket organizimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të tij; programe konkrete trajnimi për trajnerët, me qëllim përdorimin e metodave më të avancuara të mësimdhënies duke ruajtur parimet e pavarësisë akademike.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit për mësimdhënie nëpërmjet platformës e-learning në formën e organizimit të aktiviteteve të trajnimit në distancë si dhe shfrytëzimi i bazës së të dhënave në lidhje me realizimit të programeve të formimit profesional (fillestar dhe vazhdues).

Marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe me Avokaturën e Shtetit në përmbushjen e nevojave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe të kategorive të tjera, me ndryshimet ligjore, si pasojë e reformës në drejtësi.


**Rezultati 4.** Kapacitete të shtuara për realizimin e punës kërkimore dhe publikimeve drejt rritjes së cilësisë dhe ofrimit të literaturës juridike shkencore dhe bashkëkohore:

- nëpërmjet analizave të vazhdueshme të hulumtimit dhe jurisprudencës përmes botimeve në baza periodike;
- nëpërmjet komenteve elektronike, mendimeve dhe informacioneve mbi ligjet dhe praktikën gjyqësore pas punës kërkimore përkatëse;
- përmes botimeve të aksesueshme për të gjithë aktorët dhe praktikantët e ligjit;
- aktiviteteve të shtuara të kërkimit dhe përkthimit.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë grafike objektivat dhe rezultatet e pritshme.

Në planin e veprimit detajohen konkretisht rezultatet e matshme në kohë dhe në vlera financiare.

## Struktura e zgjidhjes



**Plani i zhvillimit institucional – Plan Veprimi 2019 -2023 me indikatorët dhe synimet për Shkollën e Magjistraturës**

Objektiv specifik; rezultati i pritur; aktiviteti	Indikatori	Linja bazë  Viti 2018	Synimet				Mjetet e verifikimit	Supozime/komente
			2019	2020	2021	2022-23		
Objektiv i përgjithshëm: SHM po kontribuon për të përmirësuar performancën e sistemit të drejtësisë dhe të gjithë kulturës ligjore.								
<b>Objektiv specifik: SHM ka kapacitete akademike dhe operative të mjaftueshme</b>	Përqindja e magjistratëve të diplomuar në vit							
<b>Rezultati i pritur 1:</b> SHM ka infrastrukturë të mjaftueshme	Përfitimi i hapësirave të përkohshme	Është identifikuar nevoja kalimtare për 2500 m <sup>2</sup> hapësirë	<ul style="list-style-type: none"> <li>SHM e ushtron veprimtarinë e saj në mjediset të përkohshme (tetor- dhjetor)</li> </ul>	Hapësira të përkohshme	Hapësira të përkohshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorimi i hapësirave të përkohshme e përfundon</li> </ul>	Dokumentacion administrativ	Qeveria siguron mjediset e përkohshme
	Ecuria e ndërtimit të SHM-së së re	Kapaciteti aktual përmbush 20-25% të nevojave.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Financimi i projektit të zbatimit</li> <li>Projektimi</li> <li>Leja e ndërtimit</li> <li>Sigurimi i financimit nga fondet e buxhetit për ndërtimin e godinës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Firmosja e kontratës së ndërtimit</li> <li>Fillimi i ndërtimit</li> <li>Mbikëqyrja dhe ndërtimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbikëqyrja dhe ndërtimi</li> <li>Përfundimi i ndërtimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pajisja me infrastrukturën e nevojshme</li> <li>SHM funksionon në ambientet e reja</li> </ul>	Dokumentacion administrativ	Qeveria siguron financimet e nevojshme për ndërtimin e godinës, të cilat do të rimbursohen nga fondet e BE-së, parashikuar në programin IPA 2018.

			<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedurat e tenderimit për kontratën e ndërtimit</li> </ul>					
<b>Rezultati i pritur 2:</b> SHM ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare	Përqindja e financimit krahasuar me financimin e planifikuar <sup>1</sup>	Aktualisht kemi 56% të buxhetit për vitet në vijim të siguruar nga buxheti i (PBA) dhe donatorët	99%	51%	45%	36%	Projekt buxhetet dhe raportet financiare për buxhetin e SHM-së <sup>2</sup>	Qeveria dhe donatorët sigurojnë financimet e nevojshme
	Përqindja e stafit të nevojshëm aktualisht në funksion	Nevojiten vetëm 30% e burimeve njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Politikat zhvillimore të stafit</li> <li>• 70% e stafit është aktualisht në funksion</li> </ul>	80% e stafit është aktualisht në funksion	90% e stafit është aktualisht në funksion	100% e stafit është aktualisht në funksion	Dokumentacion administrativ	Rekrutimi i stafit të kualifikuar mësimor, kërkimor dhe administrativ është një proces i vazhdueshëm i monitoruar nga Këshilli Drejtues, Drejtori dhe Kancelari.

<sup>1</sup> Përfshirë investimin për ndërtimin e godinës së re, e cila arrin shifrën 6 milionë euro (e pa konfirmur nga studio projektuese) për një periudhë 3-vjeçare (ndërtim + arredim).

<sup>2</sup> Buxheti i parashikuar është mbështetur në PBA 2019-2021 dhe metodologjia e përllogaritjes së projektbuxhetit efikon disponibilitetin e fondeve buxhetore sipas viteve. Ky buxhet negocohet përpara fillimit të çdo viti fiskal.



<p><b>Rezultati i pritur 3:</b> - Trajnimi cilësor dhe metodologjia e testimit është në funksion si edhe rezultatet e trajnimit janë në përputhje me nevojat</p>	<p>Pikat kyçe për zhvillimin e kurikulës</p>	<p>Kurikula ekzistuese për Trajnimin Fillestar dhe të Vazhduar është në proces rishikimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nevojiten vlerësime nevojash për testet e pranimit për kandidatet për magjistratë, këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit;</li> <li>• Nevojiten vlerësime nevojash për kurikulën ekzistuese për trajnimin fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit;</li> <li>• Është hartuar testi i kancelarëve në detyrë;</li> <li>• Është hartuar provimi i</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Është përmirësuar provimi i pranimit për kandidatët për magjistratë;</li> <li>• Është përmirësuar kurikula ekzistuese për trajnimin fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnimi i trajnerëve mbi kurikulën dhe metodologji në mësimore të përmirësuar.</li> </ul>	<p>Trajnimi i trajnerëve mbi kurikulën dhe metodologjinë mësimore të përmirësuar.</p>	<p>Dokumentacion administrativ</p>	
--	--	--	--	--	---	---	------------------------------------	--

			pranimit për kancelarët; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Është hartuar kurikula e re për kancelarët</li> </ul>					
	Numri i kandidatëve për magjistratë të rekrutuar çdo vit	Në këtë vit janë rekrutuar vetëm 9 kandidatë për magjistratë nga radhët e subjekteve <i>ex officio</i>	50	75	75	75 + 75	Dokumentacion administrativ	Numrit prej 50 kandidatësh të parashikuar për vitin 2019 mund t'i shtohet një numër prej 25 vendesh (gjithsej 75), në rast se nuk do të ketë aplikime në procesin e konkurrimit për kandidatët për ndihmës ligjorë dhe për avokatë të shtetit.
	Numri i kandidatëve për magjistratë të diplomuar çdo vit	Në këtë vit janë diplomuar vetëm 16 kandidatë për magjistratë	25	23	0	50 + 75	Dokumentacion administrativ	
	Numri i sesioneve të Trajnimit	230	120	130	140	150	Dokumentacion administrativ	Këtu përfshihen deri në 2 aktivitete në vit nëpërmjet

	Vazhdues për magjistratët për vit							platformës e-learning
	Numri i kancelarëve në Trajnimin Fillestar për vit <sup>3</sup>	0	Jo më shumë se 25	0	0	Jo më shumë se 20	Dokumentacion administrativ	
	Numri i sesioneve të Trajnimit të Vazhduar për kancelarët për vit	2	10	10	10	10	Dokumentacion administrativ	
	Numri i këshilltarëve ligjorë dhe avokatëve të shtetit në Trajnimin Fillestar <sup>4</sup> për vit	0	Jo më shumë se 25	Jo më shumë se 25	Jo më shumë se 25	Jo më shumë se 25	Dokumentacion administrativ	
	Numri i sesioneve trajnuese të Trajnimit të Vazhduar për këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit për vit	0	10	10	10	10	Dokumentacion administrativ	

<sup>3</sup> Periudha e trajnimit për këtë kategori është vetëm 3 muaj, një herë në 3 vjet.

<sup>4</sup> Programi i trajnimit është i njëjtë.

<b>Rezultati i pritur 4:</b> SHM ka rritur kapacitetet e kërkimit dhe publikimeve	Rritje e numrit të publikimeve shkencore	6	7 - Zhvillimi i politikës së dijeve dhe të drejtimit	7	8	8	Publikimet	
	Zhvillimi i mëtejshëm dhe mirëmbajtja e <i>E-commentary</i> (numri i neneve të ligjeve të komentuar)	247 nene (nga 4 ligje)	100 nene	150 nene	160 nene	200 nene	Publikime online	
	Pikat kyçe për zhvillimin e konceptit të qendrës së ekselencës së <i>EU acquis</i> dhe të të Drejtave të Njeriut dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së SHM-së në rrjetet ndërkombëtare të kërkimit	Projekt ide për konceptimin e qendrës së ekselencës				Programi dhe udhërrëfyesi	Implementimi i udhërrëfyesit	

	Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe vizibilitetit së punës	Ekziston plani i publikimeve Ekziston faqja e internetit	Zhvillimi i planit dhe përmirësimi i imazhit të rritjes së ndërgjegjësimit duke përfshirë zhvillimin e politikës së menaxhimit të dijeve	Implementimi i planit të hartuar	Implementimi i planit të hartuar	Implementimi i planit të hartuar		
--	--	---	--	----------------------------------	----------------------------------	----------------------------------	--	--



## KAPITULLI IV

### MONITORIMI DHE ANALIZA E ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMEVE

**K**y plan veprimi është mbështetur në objektiva të përgjithshme dhe specifike të parashikuara në Strategjinë e Shkollës së Magjistraturës 2019-2023, me synimin për të parashtruar, parashikuar dhe përcaktuar sa më qartë përgatitjen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe profesional të të gjitha kategorive, objekt i veprimtarisë së Shkollës.

Në zbatim të një metodologjie të qartë e gjithëpërfshirëse, PV-ja jep veprime konkrete me indikatorë të qartë për përmirësimin dhe menaxhimin më efektiv të veprimtarisë së Shkollës, përsa i takon politikave akademike, financiare dhe administrative për përmbushjen e qëllimeve strategjike, apo më konkretisht të detyrimeve të reja dhe të një roli përcaktues që ka Shkolla e Magjistraturës në procesin reformues të reformës në drejtësi në Shqipëri.

Të gjitha masat në Planin e Veprimit të kësaj strategjie janë të prioritizuara, të buxhetuara dhe të ndara në faza. Ndarja e masave që do të ndërmerren, sipas fazave, është kryer në përputhje me kapacitetet absorbuese të pritshme të Shkollës së Magjistraturës. Qëllimi i ndarjes në disa faza ndjek rrjedhën logjike që zbatimi i tyre të realizohet edhe në mënyrë kronologjike.

Shkolla e Magjistraturës monitoron Strategjinë nëpërmjet strukturave të brendshme të saj. Kjo strukturë menaxhuese mbledh dhe analizon raportet periodike për zbatimin e planit të veprimit. Çdo sektor raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo politike dhe aktiviteti, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Për rrjedhojë, ky mekanizëm do të jetë përcaktues në vendimmarrjen lidhur me masat korrigjuese, strukturën përgjegjëse për korrigjim dhe sanksionet e duhura. Për këtë qëllim, do të analizohen për secilin aktivitet treguesit e performancës, si: raportet e vlerësimit, rekomandimet, pyetësorët e plotësuar, pasojat e shkaktuara.

Struktura përgjegjëse për monitorimin e kësaj strategjie do të jetë:

- Kancelari i Shkollës;
- Këshilltari akademik;
- 3 pedagogë të brendshëm (Formimi Fillestar, Formimi Vazhdues dhe Publikimet);
- 3 përgjegjës të sektorëve (Formimi Fillestar, Formimi Vazhdues dhe Publikimet).

Zbatimi i Strategjisë do të monitorohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit të performancës dhe rezultateve të parashikuara në Planin e Veprimit, i cili mbështet qëllimet e politikave dhe objektivat e programit dhe garanton që planifikimi i politikave, buxhetimi dhe monitorimi të jenë të lidhura dhe të veprojnë në mënyrë efikase. Ky sistem do të shërbejë si bazë për përgatitjen e PBA-së dhe procesin e buxhetit vjetor, duke ofruar objektivat e politikave, të cilat përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha institucionet.

Treguesit e performancës janë krijuar nga struktura e monitorimit për të arritur:

**Objektivin e përgjithshëm.** Të kontribuojmë në rritjen e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në funksion të nevojave që rrjedhin nga reformat e vazhdueshme të drejtësisë, si dhe të kontribuojmë në përmirësimin e kulturës ligjore në sektor dhe në vend e në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

**Objektivin specifik.** Shkolla e Magjistraturës synon të ketë kapacitetet akademike dhe administrative të mjaftueshme për realizimin normal të veprimtarisë së saj.

**Rezultati i pritshëm 1:** Kapacitete infrastrukurore të duhura për zhvillimin normal të aktivitetit akademik e administrativ, si dhe infrastruktura e përkohshme dhe financimi i siguar si

pasojë e kërkesës përkohësisht të lartë për nxjerrjen e magistratëve, për të garantuar zëvendësimin e domosdoshëm si pasojë e procesit të *vetingut*.

Përsa i takon rezultatit të pritshëm 1, apo infrastrukturës, ajo luan rolin kryesor në rritjen e kapacitetit për përballimin e kërkesave të pritshme për formimin profesional jo vetëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj por edhe të këshilltarëve ligjorë, avokatëve të shtetit dhe kancelarëve. Rritja e pritshme e numrit të përfituesve të formimit profesional që ofron Shkolla si pasojë e efekteve të reformës, do të kërkojë pasjen e mjediseve/klasave të nevojshme dhe të përshtatshme për kategoritë e sipërpërmendura. Ky rezultat do të matet nëpërmjet dy treguesve:

**1. Përfitimi i mjediseve të përkohshme.** Pasi kemi identifikuar që kapacitetet aktuale përmbushin vetëm 25% të nevojave, në vitin 2019 Shkolla duhet të transferohet menjëherë në mjedis të tjera për një periudhë 3-5 vjeçare, me një sipërfaqe minimale 2500 m<sup>2</sup>, deri në ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magistraturës. Këto mjedisë duhet të sigurohen nga Këshilli i Ministrave. Në rast se nuk ka mundësi transferimi në ndërtesa publike, atëherë e vetmja zgjidhje do të mbetet që Shkolla të përgatitet për marrjen me qira të sallave për realizimin e Programit të Formimit Vazhdues (2-3 salla në ditë), ndërkohë që duhet të menaxhojë me vështirësi mjediset aktuale (3-4 salla) për Formimin Fillestar të kandidatëve për magistratë, këshilltarëve/ndihmësve ligjorë/avokatëve të shtetit dhe kancelarëve.

**2. Ecuria e ndërtimit të godinës së re të SHM-së.** Me vendimin nr. 442, datë 20.5.2015 të Këshillit të Ministrave është ngarkuar AKPT-ja (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) për zhvillimin e konkursit të projektimit dhe përftimin e projektit të zbatimit të godinës së Shkollës së Magistraturës. Në zbatim të VKM-së është lidhur kontrata me firmën fituese Sadar&Vuka dhe Varka Arkitekturë për projektin e zbatimit me vlerë 18.500 mijë lekë me afat deri në qershor të vitit 2019. Gjatë vitit 2019 duhet të sigurohet fondi i financimit dhe të përcaktohet struktura përkatëse për zhvillimin e procedurës së prokurimit për ndërtimin e godinës së re, e cila duhet të përfundojë në vitin 2022. Sa i përket burimit të financimit ky do të sigurohet fillimisht nga buxheti i shtetit, i cili do të rimbursohet nga fondet e BE-së, projekti IPA, në përfundim të ndërtimit të godinës dhe dorëzimit të saj Shkollës së Magistraturës.

### **Rezultati i pritshëm 2:** Burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

Rezultati i pritshëm 2 vijon të plotësojë panoramën e rritjes së efektshmërisë së Shkollës. Sigurisht që rritja e kapaciteteve të brendshme dhe përballimi me sukses i sfidave të reja kërkon edhe përmbushjen e nevojave përkatëse buxhetore dhe njerëzore që do t'u përgjigjen ndryshimeve të brendshme organizative dhe infrastrukturore të Shkollës.

Ky rezultat do të matet nëpërmjet dy treguesve:

**1. Përqindja e financimit krahasuar me financimin e planifikuar.** Aktualisht Shkolla ka siguruar fondet vjetore të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së saj për vitin 2019. Synon që nëpërmjet PBA-së të sigurojë një qëndrueshmëri financiare nëpërmjet buxhetit të shtetit, e cila do të përballojë 100% nevojat e saj. Në planin e veprimit parashikohet që këto nevoja të plotësohen sipas PBA-së për vitin 2020 me 51%, për vitin 2021 me 45% dhe për vitet 2022-23 me 36%.

**2. Përqindja e stafit të nevojshëm aktualisht në funksion.** Aktualisht ka një staf prej 31 punonjësish me kohë të plotë, të cilët plotësojnë rreth 70% të nevojave. Synon ta shtojë atë me 2-3 persona (staf akademik dhe administrativ) çdo vit, duke riparë strukturën e saj organizative dhe duke synuar që në vitin 2023 të ketë 45-50 persona staf të brendshëm.

**Rezultati i pritshëm 3:** Programet e formimeve profesionale fillestare dhe të vazhduara për magjistratët dhe kategoritë e tjera sipas ligjit realizohen sipas një metodologjie rekrutimi dhe kurikulash trajnimi të përditësuara, gjithëpërfshirëse dhe të mjaftueshme.

Ky rezultat do të matet nëpërmjet shtatë treguesve:

**1. Pikat kyçe për zhvillimin e kurikulës.** Është evidentuar nevoja për rishikimin e kurikulave ekzistuese për Trajnimin Fillestar dhe të Vazhduar. Për arritjen e këtij rezultati nevojiten vlerësime nevojash për testet e pranimit dhe për kurikulën ekzistuese për Trajnimin Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit, me qëllim përmirësimin e provimit të pranimit për kandidatët për magjistratë dhe përmirësimin e kurikulave ekzistuese për Trajnimin Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit. Është përgatitur kurikula e re për kandidatët për kancelarë.

## **2. Numri i kandidatëve që do të rekrutohen çdo vit në Trajnimin Fillestar.**

### **1) Numri i kandidatëve për magjistratë që do të rekrutohen çdo vit.**

KLGG-ja dhe KLP-ja caktojnë numrin e vendeve vakante. Për shkak të procesit të *vetingut*, nevojat e sistemit mund të jenë të mëdha, por, për vitin 2019, Shkolla nuk mund të rekrutojë më shumë se 50 kandidatë në vit<sup>5</sup> (me një prirje për rritje të arsyeshme prej 25 kandidatësh çdo vit), për disa arsye:

- a) **Së pari**, për shkak të numrit të vogël dhe jo cilësor të kandidatëve që konkurrojnë për të marrë pjesë në konkursin e pranimit.
- b) **Së dyti**, për shkak të pamundësisë së rekrutimit të trupës pedagogjike me kohë të pjesshme, e cila duhet të jetë e një niveli të lartë profesional dhe moscenimit, në këtë mënyrë, të cilësisë së mësimdhënies.

### **2) Numri i këshilltarëve ligjorë dhe avokatëve të shtetit në Trajnimin Fillestar për vit.**

Kjo kategori ndjek të njëjtin program teorik si kandidatët për magjistratë. Numri i tyre përcaktohet respektivisht nga KLGJ-ja, si dhe nga Marrëveshja që do të lidhë Shkolla e Magjistraturës me Avokaturën e Shtetit. Shkolla parashikon të ofrojë trajnim fillestar për një klasë me jo më shumë se 25 kandidatë çdo vit.

**3. Numri i kandidatëve për magjistratë të diplomuar çdo vit.** Ky numër është i njëjtë si në hyrje dhe në dalje.

**4. Numri i sesioneve të Trajnimit Vazhduar për magjistratët për vit.** Për shkak të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në seminar nga çdo magjistrat në detyrë, minimalisht 5 ditë në vit dhe maksimalisht 40 ditë në vit, Shkolla është përpjekur të parashikojë për vitin 2018-2019 rreth 230 sesione trajnuese në vit, duke i dhënë mundësinë çdo magjistrati të ndjekë 20 ditë trajnimi në vit. Por, në kushtet e emergjencës që paraqet rritja e numrit të kandidatëve për të gjitha grupet në Programin e Formimit Fillestar, Shkolla do të përqendrohet më shumë në këtë drejtim, duke parashikuar të ulë në mënyrë të arsyeshme numrin e aktiviteteve trajnuese për vitet e ardhshme në rreth 120-150 sesione trajnuese dyditore në vit, duke i dhënë mundësinë çdo magjistrati të ndjekë mesatarisht 10 ditë trajnimi në vit.

**5. Numri i kancelarëve në Trajnimin Fillestar për vit.** Ky numër përcaktohet nga KLGJ-ja dhe KLP-ja. Shkolla ka parashikuar të ofrojë trajnime për një klasë prej 20-25 personash çdo tre vjet.

<sup>5</sup> Këtij numri mund t'i shtohet numri 25 (gjithsej 75), për vitin 2019, në rast se nuk do të ketë aplikime në procesin e konkurrimit për kandidatët për ndihmës ligjorë dhe për avokatë të shtetit.

**6. Numri i sesioneve të Trajnimit Vazhdues për kancelarët për vit.** Edhe për këtë kategori parashikohet të ofrohen deri në 10 sesione trajnuese në total në vit.

**7. Numri i sesioneve trajnuese të Trajnimit Vazhdues për këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit për vit.** Për këto kategori janë parashikuar sesione trajnuese të veçanta, rreth 10 sesione trajnuese në vit, të cilat mund të koordinohen me sesionet trajnuese të ofruara për magjistratët në detyrë.

**Rezultati i pritshëm 4:** Kapacitete të shtuara për realizimin e punës kërkimore dhe publikimeve drejt rritjes së cilësisë dhe ofrimit të literaturës juridike shkencore dhe bashkëkohore.

Sigurimi i analizave të vazhdueshme cilësore nga hulumtimet dhe praktika gjyqësore nëpërmjet botimeve periodike është komponent i domosdoshëm në përmbushjen e synimit strategjik të Shkollës për përmirësimin e kulturës ligjore në vend.

Ky rezultat do të matet nëpërmjet katër treguesve:

**1. Rritja e numrit të publikimeve shkencore.** Synohet të shtohet numri i botimeve shkencore me baza periodike, manuale, cikle leksionesh, përkthime të ndryshme shkencore etj.

**2. Zhvillimi i mëtejshëm dhe mirëmbajtja e komentarit elektronik (numri i neneve të ligjeve të komentuara).** Ky komentari është një risi në drejtim të punës kërkimore-shkencore dhe interpretimit të dispozitave të ndryshme ligjore, duke i dhënë mundësinë çdo praktikanti të njohë praktikën gjyqësore mbi zbatimin e ligjit. Shkolla duhet të marrë masat për të siguruar fondet e nevojshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e këtij komentari si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së tij për të ardhmen.

**3. Pikat kyçe për zhvillimin e konceptit të qendrës së ekselencës së EU *acquis* dhe të Drejtave të Njeriut, si dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së SHM-së në rrjetet ndërkombëtare të kërkimit.**

Aktualisht ka një projekt ide mbi konceptimin e kësaj qendre, por nevojitet të hartohet një program konkret dhe implementimi i tij në të ardhmen e afërt, duke siguruar burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme, për një periudhë që mund ta kalojë periudhën objekt të kësaj Strategjie. Realizimi e monitorimi mund të arrihen nëpërmjet realizimit të komponentëve, si:

- Ofrimi i trajnimeve të specializuara të magjistratëve dhe kandidatëve për magjistratë në përputhje me ligjin dhe standardet e BE-së;
- Hartimi dhe dorëzimi i moduleve të trajnimit dhe aktiviteteve për profilizimin e magjistratëve në fusha të ndryshme të ligjit;
- Sigurimi i trajnimit të përshtatur për profilet e gjyqtarëve/prokuratorëve sipas pozicionit të tyre aktual dhe perspektivës së tyre;
- Konsolidimi i bashkëpunimit me institucionet partnere ndërkombëtare për shkëmbimin e njohurive;
- Administrimi dhe ofrimi i programeve praktike me institucionet ndërkombëtare.

**4. Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe imazhit të punës.** Në lidhje me këtë tregues, ekziston një faqe interneti, e cila prezanton në mënyrë dinamike të gjithë veprimtarinë akademike të Shkollës. Ka plane vjetore për publikimet dhe botimet shkencore që Shkolla realizon, por ka nevojë për zhvillimin e një plani për përmirësimin e imazhit të rritjes së ndërgjegjësimit, duke përfshirë zhvillimin e politikës së menaxhimit të dijeve.

### Plani i ndikimit financiar sipas indikatorëve për vitet 2019-2023

Objektivi specifik, rezultati i papritur, aktiviteti	Indikatori	Synimet							
	Linja bazë viti 2018		2019	2020		2021		2022-23	
		Nr.	Vlerë ALL	Nr.	Vlerë ALL	Nr.	Vlerë ALL	Nr.	Vlerë ALL
<b>Rezultati i pritur 1: SHM ka infrastrukturë të mjaftueshme</b>	Përfitimi i hapësirave të përkohshme	qira salle	600,000	qira	3,900,000	qira	4,200,000	qira	4,500,000
	Ndërtim godine + arredim godine				246,000,000		246,000,000		246,000,000
<b>Rezultati i pritur 2: SHM ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare</b>	Fondet e buxhetit sipas PBA 2019-2021		178,700,000		235,000,000		235,000,000		235,000,000
	Përqindja e stafit të nevojshëm në funksion		70%		80%		90%		100%
<b>Rezultati i pritur 3: trajnimi cilësor dhe metodologjia e testimit është në funksion si edhe rezultatet e trajnimit janë në përputhje me nevojat</b>	Numri i kandidatëve për magistratë të rekrutuar çdo vit gjyqtarë / prokurorë	50	51,666,366	75	72,709,740	75	147,558,233	75+75	175,620,683



	Numri i kandidatëve për magistratë të diplomuar çdo vit	25	15,646,500	23	25,130,914	0		125	105,960,600
	Numri i sesioneve të Trajnimit Vazhdues për magistratët për vit	120	57,323,015	130	55,166,808	140	58,216,808	150	61,387,308
	Numri i kancelarëve në Trajnimin Fillestar për vit.	25	8,253,000					20	8,001,850
	Numri i sesioneve të Trajnimit Vazhdues për kancelarët për vit	10	4,237,000	10	2,946,000	10	2,961,000	10	2,974,700
	Numri i këshilltarëve ligjorë dhe avokatëve të shtetit në Trajnimin Fillestar për vit.	25	23,946,500	25	35,085,059	25	37,415,750	25	31,116,100
	Numri i sesioneve trajnuese të Trajnimit Vazhdues për këshilltarët ligjorë dhe avokatët e shtetit për vit.	10	2,717,000	10	2,946,000	10	2,961,000	10	2,974,700

<b>Rezultati i pritur 4: SHM ka rritur kapacitetet e kërkimit dhe publikimeve</b>	Rritje e numrit të publikimeve shkencore	7	14,910,619	7	18,623,000	8	20,374,800	8	21,474,800
<b>TOTALI</b>			<b>179,300,000</b>		<b>462,507,520</b>		<b>519,687,590</b>		<b>660,010,741</b>

**Shënim:** Në vlerën e buxhetit vjetor janë përfshirë: paga e sigurime shoqërore/ shëndetësore të stafit të brendshëm, orë mësimore për programet e Formimit Fillestar dhe Vazhdues, bursa dhe shpërblime për kandidatët për magjistratë, ndihmësat ligjorë dhe kancelarët, vizitë studimore të kandidatëve për magjistratë në kuadër të programit mësimor, (GJEDNJ dhe GJED), Organizimi i Konferencës vjetore të Shkollës, qira sallash për Programin e Formimit Vazhdues, si dhe shpenzime të tjera operative për mirëmbajtjen e funksionimin normal të aktivitetit të Shkollës. Gjithashtu, është parashikuar edhe vlera e investimeve për mjediset e reja të Shkollës, (ndërtimi i godinës, arredim blerja e pajisjeve elektronike) dhe librave për bibliotekën e Shkollës.